

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 5  
10.12.2010

NR. VENDIMI 2  
16.03.2011

**VENDIM**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

**Liljana BAKU**            **K/ trupit gjykues**  
**Iliriana OLLDASHI**    **Anëtare**  
**Luan HASNEZIRI**      **Anëtar**

Asistuar nga sekretare seance **Andina KAJA**, sot në datë 16.03.2011, përfundoi në seancë gjyqësore publike, gjykimin e kërkesës Nr 5/19 Rregjistri që i përket palëve:

**KËRKUES:**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokuror **B. M. .**

**KUNDËR**

**SHTETASIT NËN HETIM**

**M. K.**, i biri i N. dhe i K., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në fshatin xxxxxxxx, Komuna xxxxxxxxxxx xxxxxxxx, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, mbrojtur, sipas Prokurorës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. xxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesit e tij të posaçëm, Av. A. H. Nr.xxx Liçense dhe Av. E. H. me Nr. xxxx Liçense, Nr. Nipti K. xxxxxxxxxxx M, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**PERSONAVE TË TRETË:**

**1.**    **N. K.**, i biri i L. dhe i D., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në fshatin xxxxxxxx, Komuna xxxxxxxxxxx xxxxxxxx, me shtetësi dhe

kombësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, mbrojtur sipas Prokurorës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. Xxx Kol. datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesit e tij të posaçëm Av. A. H. Nr.xxx Liçense dhe Av. E. H. me Nr.xxxx Liçense, Nr. Nipti K. xxxxxxxx M, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**2. B. K.**, e bija e L. dhe e H. , e datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banuese në fshatin xxxxxxxx, Komuna xxxxxxxx xxxxxxx, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, mbrojtur sipas Prokurorës së Posaçme Nr. xxxx Rep. Nr. xxx Kol datë xx.xx.xxxx, nga përfaqësuesit e saj të posaçëm, Av. A. H. Nr.xxx Liçense dhe Av. E. H. me Nr.xxxx Liçense, Nr. Nipti K. xxxxxxxx, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**OBJEKTI:**

**Konfiskimi i pasurive:**

**1.** Një apartament banimi, me sipërfaqe xxx mx, ndodhur në katin e shtatë të pallatit në rrugën «xx xxxxx », xxxxx, përfituar nga shtetësja B. L. K. me Kontratën e Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxxx Kol, datë xx.xx.xxxx të lidhur me Shoqërinë «xxxx » Sh.P.K, me administrator shtetasin M. S..

**2.** Një apartament, me sipërfaqe banimi xx mx dhe sipërfaqe të përbashkët x.x mx, ndodhur në katin e tretë të një pallati në xxxxx xxxxx, së bashku me garazhin, përfituar nga shtetasi N. L. K. me Kontratën e Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxx Kol, datë xx.xx.xxxx, të lidhur me shoqërinë «xxxxxxxx» Sh.P.K, me administrator shtetasin P. K..

**3.** Një mjet, tip xxx, me targa xx xxxx x, rregjistruar në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor xxxxx, në datë xx.xx.xxxx, në emër të shtetasit M. N. K..

**4.** Një llogari bankare, çelur pranë Bankës Popullore, me Nr. xxxxxxxx/xx, në emër të shtetasit M. N. K., në shumën 301 064 (treqind e njëmijë e gjashtëdhjet e katër) lekë.

Për ekzekutimin e vendimit të ngarkohen Zyrat e Përmbartimit në Tiranë dhe Kavajë dhe administratorët e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, M. H. dhe I. D..

**BAZA LIGJORE:**

Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në përfundim të gjykimit, në kushtet e qënies së saj kompetente për të gjykuar dhe vendosur në bazë të nenit 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi shqyrtoi provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve në të cilat u kërkua:

**Prokurori B. M.:** Pranimin e kërkesës duke u konfiskuar dy apartamentet e banimit sipas përshkrimit në objektin e kërkesës.

Heqjen dorë nga kërkesa për konfiskimin e llogarisë bankare Nr. xxxxxx/xx pranë Bankën Popullore, në shumën 301 064 lekë dhe, makinës tip xxxx me targa xx xxxx x, në emër të shtetasit M. K..

Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të konfiskuara të ngarkohet Znj, E. Ç. , administratore e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë dhe, për ekzekutimin e vendimit Zyra e Përmbartimit Tiranë.

**Përfaqësuesi i Posaçëm, Av. A. H.:** Rrëzimin e kërkesës me objek konfiskimin e dy apartamenteve të banimit dhe pushimin e gjykimit për konfiskimin e llogarisë bankare dhe makinës tip Ford, meqënëse pala kërkuese hoqi dorë.

## V Ë R E N

Shtetasi nën hetim M. K. ka lidhje të afërt gjinore me personat e tretë, duke qënë shtetasi N. K. babai i tij dhe shtetësja B. K. bashkëshortja e tij.

Në datë 11.02.2010 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rregjistruar procedimin penal Nr. 659 viti 2010, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Rregjistrimi i këtij procedimi është bërë mbi bazën e informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave mbi një rast të dyshimtë të pastrimit të produkteve të veprës penale nga shtetasit shqiptarë E. dhe E. Z., L. B., O. S., M. K. dhe S. C.. Nga aktet bashkëngjitur informacionit ka rezultuar se këta shtetas janë duke u hetuar nga Prokuroria e Athinës, për shkelje të neneve 45, 94, 322 dhe 385 të Kodit Penal Grek që kanë të bëjnë me pengmarrje, kërcënim në bashkëpunim dhe armëmbajtje pa lejë. Veprat penale

për të cilat hetohen janë kryer prej tyre në periudhën kohore 19.06.2009-25.06.2009 dhe kanë të bëjnë me rrëmbimin e shtetasës greke E. A. F., kërcënimin e shtetasit grek A. S. Th., mik i të dëmtuarës, që ka bërë pagesën në kesh të shumës prej 1.800.000 euro, me qëllim lirim të saj.

Në datë 03.05.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rregjistruar procedimin pasuror në ngarkim të shtetasit nën hetim M. N. K., duke qënë ai rrjedhojë e procedimit penal të filluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga materiali hetimor, që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rezultuar se, nëpërmjet Oficerit të Kontaktit në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë, është përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shkresa Nr. 1047/3/250/2-p4a datë 02.02.2010 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Greqisë, mbi ndalimin e disa shtetasve shqiptarë. Nga përmbajtja e saj ka rezultuar se kjo e fundit (Drejtoria e Policisë Greke) ka referuar pranë Prokurorisë së Athinës nisjen e procedimit penal në ngarkim të tetë të akuzuarve (prej të cilëve gjashtë shtetas shqiptarë), për shkelje të neneve 45, 94, 322 dhe 385 të Kodit Penal Grek, në lidhje me rrëmbimin e shtetasës greke E. F.. Ndërmjet shtetasve për të cilët është urdhëruar ndalimi rezulton edhe shtetasi M. K. , për të cilin është shpallur kërkim ndërkombëtar.

Nga të dhënat e marra nga Sistemi TIMS mbi hyrje-daljet e shtetasit M. K. ka rezultuar se ky shtetas, së bashku me bashkëshorten e tij B. K. , ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në datë 25.06.2009 ora 22.06, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë. **Data e hyrjes së shtetasit M. K. në territorin e shtetit shqiptar përkon me përfundimin e aktivitetit kriminal në Greqi.**

Në kuadër të hetimit pasuror të ndërmarë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rezultuar sa më poshtë:

Shtetasit M. K. dhe N. K. , kanë çelur një llogari bankare pranë Bankës Popullore në të cilën, në datë 06.07.2009, kanë kredituar shumën prej 70 000 Euro, të deklaruar si “E ardhur nga emigracioni” (Shkresa Nr. 1791/1 datë 11.03.2010 e Bankës).

Në bazë të Kontratës së Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxx Kol datë 06.07.2009, shtetasi N. L. K. ka porositur tek shoqëria ndërtuese “xxxxx” SH.P.K, një apartament banimi me sipërfaqe xx mx, ndodhur në katin e tretë të pallatit në Golem, kundrejt çmimit 70 000 Euro. Në datë 06.07.2009 shuma prej 70000 Euro, nga llogaria bankare, sipas Deklaratës Nr. 4758/602 datë 06.07.2009 , është transferuar në drejtim të shtetasit B. P., si pagesë për blerje apartamenti.

Shtetasja B. K. , në datë 28.10.2009, ka blerë një apartament banimi tek Shoqëria “xxxxx” Sh.P.K, kundrejt çmimit prej 137.800, shumë e cila është likuajduar jashtë sistemit bankar. Nga përmbajtja e Kontratës së Sipërmarrjes Nr.xxxx Rep, Nr.xxxx Kol datë

28.10.2009 ka rezultuar se shtetasja B. K. ka porositur tek Shoqëria “xxxxx” Sh.P.K, me ortak dhe administrator shtetasin M. S. , një xxxxxxxxxxxx xxxxxx me sipërfaqe xxx mx, ndodhur në xxxxxx e xxxxxx në Rrugën “Zef Jubani” Tiranë.

Nga kqyrja e dokumentacionit, ndodhur në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, ka rezultuar se shtetasi M. K. është përdorues edhe i një automjeti tip xxxx me targa xx xxxx x.

Mbi bazën e faktit se shtetasi M. K. së bashku me familjarët e tij nuk ushtronin ndonjë aktivitet tregëtar të rregjistruar dhe kanë deklaruar si burim të ardhurash “Emigracionin”, prokuroria ka ngritur dyshimin për kryerje prej tij të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal duke vendosur masën e sekeustros mbi pasuritë e përshkruara më sipër. Gjithashtu, duke çmuar se ndodhet para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor i’ a ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me Vendimin Nr. 8 datë 11.06.2010, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ka vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë objekt konfiskimi. Ky vendim është lënë në fuqi me Vendimin Nr. 22 datë 22.07.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë duke urdhëruar pezullimin e pasojave të zbatimit të kësaj mase deri në dhënien e vendimit gjyqësor penal.

Në vendosjen e sekuestros (shih vendimin e mësipërm) gjykata ka arsyetuar qënien e shtetasit M. dhe personave të tretë, babait të tij shtetasit N. dhe bashkëshortes së tij B. , si subjekte të zbatimit të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, në referim të nenit 3 pika 1 gërma “d” dhe pika 2 gërma “a” të tij. Është konstatuar prej saj ekzistenca e kritereve të përgjithshme për vendosjen e masës së sekuestros dhe që lidhen me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje për pjesmarrje të shtetasit M. në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji si dhe, e zotërimit të pasurive që nuk i përgjigjeshin dukshëm nivelit të të ardhuarve (të parashikuara si të tilla në nenin 11 pika “a” dhe “b”). Gjithashtu është arsyetuar edhe ekzistenca e kriterit të veçantë që lidhet me praninë e rrezikut të tjetërsimit apo humbjes së pasurive (e parashikuar në gërmën “a” të pikës 1 të nenit 11 të Ligjit).

Në datë 10.12.2010 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesën me objekt konfiskimin e pasurive të përshkruara hollësisht në pjesën hyrëse të vendimit.

Në kushtet kur barra e provës, në zbatim të këtij ligji, i përket personit pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet (pika 3 e nenit 21 të Ligjit) gjatë gjykimit, nga ana e përfaqësuesit të

posaçëm të shtetasit nën hetim dhe personave të tretë, u paraqitën me cilësinë e provës deklaratat e të ardhurave vjetore të shtetasve M. dhe N. K., të përpiluara në Drejtorinë e Shërbimeve Ekonomike, Bashkia Pire, për periudhën nga Viti 2000 deri në Vitin 2009. Këto deklarata u paraqitën me vulën apustile të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Athinë, të përkthyer dhe noterizuara, duke patur në këtë mënyrë formën e kërkuar ligjore. Në funksion të provueshmërisë së realizimit faktit të këtyre të ardhurave u paraqitën gjithashtu me cilësinë e provës edhe dokumente të Insitutit të Sigurimeve Shoqërore IKA në Greqi, për periudhën në fjalë për shtetasit M. dhe N. K.

Me qëllim përcaktimin se në ç'nivel të ardhurat e deklaruara nga shtetasit M. dhe N. K. justifikonin pasurinë objekt konfiskimi, gjykata kryesisht, në bazë të neneve 224/a dhe 227 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi kryerjen e ekspertimit kontabël. Ekspertit Gj. H. të thirrur për këtë qëllim, në realizimin e detyrës j'u kërkua që të llogariste totalin e të ardhurave të deklaruara prej shtetasve të sipërpërmendur para organit kompetent shtetëror grek si dhe totalin e shpenzimeve të familjeve të tyre (sipas përbërjes familjare të rezultuar nga çertifikatat familjare) në kufirin e minimumit jetik për shtetin grek, për periudhën vitet 2000-2009.

Në seancën gjyqësore të datës 18.02.2011, në të cilën u paraqit dhe i'u nënshtrua debati gjyqësor Akti i Ekspertimit Kontabël datë 04.02.2011, gjykata konstatoi se në realizimin e detyrës eksperti ishte bazuar në të dhënat e nxjerra nga dokumentat e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore Greke IKA dhe jo në deklaratat e të ardhurave vjetore të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Ekonomike, Bashkia Pire. Mbi këtë fakt, duke pranuar edhe kundërshtimin e prokurorit gjykata urdhëroi ripërsëritjen e aktit të ekspertimit kontabël mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga formularët e deklarimit të të ardhurave vjetore, të administruar me cilësinë e provës. Në këtë urdhërim gjykata mbajti parasysh parashikimin e nenit 24 pika 1 gërma "b" të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 që bën fjalë për nivel të ardhurash, fitimesh apo veprimtarish të ligjshme, **të deklaruara**.

Në zbatim të urdhërit të gjykatës, Eksperti Gj. H. paraqiti Aktin e Ekspertimit Kontabël datë 25.02.2011. Nga përmbajtja e tij ka rezultuar se **vlera totale e pasurisë objekt konfiskimi është 217 199 Euro**. Vlera totale e të ardhurave neto të deklaruara për periudhën 2000-2009 është 149 304 Euro ndërsa vlera totale e shpenzimeve, në kufirin e minimumit jetik është 135 487 Euro. Duke llogaritur raportin midis vlerës së pasurisë objekt konfiskimi dhe vlerës së të ardhurave të ligjshme të deklaruara (nga të cilat zbritet vlera e shpenzimeve në kufirin e minimumit jetik) eksperti ka arritur në konkluzionin se, **të ardhurat nuk arrijnë të mbulojnë vlerën e pasurisë në shumën 203 382 Euro**.

Në përfundim të gjykimit **prokurori B. M.** paraqiti pretendimet dhe kërkimet përfundimtare. Sipas tij:

**1.** Dy apartamentet e banimit objekt konfiskimi, në zotërim të shtetasve B. K. dhe N. K., si pasuri të krijuara pas përfshirjes së shtetasit nën hetim M. K. në

aktivitetin kriminal me kohëzgjatje 19.06.2009-25.06.2009, nuk kanë prejardhje të ligjshme. **Nga shtetasi nën hetim dhe personat e tretë nuk u paraqit asnjë provë mbi bazën e të cilave të justifikohet ligjshmëria e të ardhurave me të cilat janë blerë këto prona dhe si rrjedhojë ato duhet të konfiskohen.**

**2.** Llogaria bankare në emër të shtetasit nën hetim M. K., çelur në Bankën Popullore në shumën 301 066 lekë dhe mjeti me targa xx xxxx x, në zotërim të po këtij shtetasi, blerë prej tij në vitin xxxx, janë pasuri të krijuara me të ardhura të ligjshme dhe si të tilla për to nuk mund të kërkoet konfiskimi. **Mbi këtë pretendim prokurori hoqi dorë nga kërkesa për konfiskimin e tyre.**

Përfaqësuesi i posaçëm i shtetasit nën hetim M. K. dhe personave të tretë N. e B. K., **Av. A. H.** paraqiti pretendimet dhe kërkimet përfudimtare. Sipas tij:

**1.** Vendimi gjyqësor i caktimit të masës së sekuestros mbi pasuritë objekt konfiskimi, e ka konsideruar shtetasin M. K. si subjekt të zbatimit të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d” të tij për shkak të qënies si person i dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Kjo nënkupton që shtetasi M. të ketë kryer veprime kriminale të pastimit për pasuri që dihen se janë produkt i një veprë penale ndërkohë që, nuk ka një vepër penale të tillë të gjykuar. Shtetasi M. K. nuk është dënuar as për llogari të procedimit penal në shtetin grek. Mbi këtë pretendim u kërkuar rrëzimi i kërkesës për vendosjen e sekuestros (fq 3 e konkluzioneve).

Në funksion të këtij argumentimi mbrojtja kërkoi të dijë se çdo të ndodhë nëse vendoset konfiskimi dhe më pas hetimi penal apo procedurat gjyqësore e konsiderojnë të pafajshëm shtetasin M. K..

**2.** Nga ana e prokurorisë nuk u provua gjatë hetimit apo edhe gjatë këtij gjykimi se personi i dyshuar dhe personat e lidhur me të disponojnë një nivel jetese të pajustificuar.

Gjatë gjykimit u paraqitën dokumenta që tregonin deklaratimet zyrtare të të ardhurave që M. K. dhe të afërmit e tij kanë fituar gjatë punës së tyre në emigracion, shumë e cila, sipas Aktit të Ekspertimit datë 04.02.2011, rezultoi e mjaftueshme për të mbuluar shumën e trasaksioneve që dyshohet se janë kryer për të pastruar pasurinë e ardhur nga vepra penale.

**3.** Në kërkesën e prokurorit nuk sillen elemente prove dhe argumente të cilat të vërtetonin rrezikun e tjetërsimit të pasurive ndaj të cilave kërkohet masa e sekuestrimit. Është detyrë e gjykatës që të sjellë argumenta konkrete mbi të cilat bazohet për të mbështetur qëndrimin e saj se pasuritë në fjalë janë në rrezik tjetërsimi.

**4.** Në bazë të nenit 5 të ligjit një arsye tjetër ligjore për rrëzimin e kërkesës është vetë parashikimi në këtë dispozitë “*Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara sipas këtij ligji, i nënshtrohen gjithashtu sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të*

*sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji*”. Mbi pasuritë objekt shqyrtimi është vendosur masa e sekuestrimit me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 595 datë 29.03.2010 dhe si të tilla ato nuk mund t’i nënshtrohen njëkohësisht edhe masës parandaluese të parashikuar në këtë ligj të posaçëm.

**5.** Gjatë gjykimit, me provat e paraqitura prej nesh, provuam se burimi i të ardhurave me të cilat kemi realizuar pasurinë objekt konfiskimi është aktiviteti tregëtar disa vjeçar i familjes. Ky aktivitet u provua me prova të marra konform marrëveshjeve ndërkombëtare dhe që përfaqësojnë të ardhura të përfuara nga individit në shtetin grek, të cilat deklarohen mbi bazën e dokumentave për të cilat nuk mund të merret apostil pasi, janë dokumenta që lëshohen vetëm njëherë dhe kanë pullën e sigurisë. Është detyrë e gjykatës që të garantojë marrjen e tyre në rrugën e kërkuar nga ligji, duke siguruar një proces të rregullt ligjor.

Gjykata, në analizë të provave të paraqitura dhe marra në gjykim, konkludon se kërkesa e prokurorit për konfiskimin e dy apartamentev të banimit, në zotërim të shtetasit nën hetim dhe personave të tretë, është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

Në pikën 1 të nenit 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” parashikohet shprehimisht:

*“Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:*

*a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicje, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;*

*b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe*

*c) kur rezulton se pasuria është drejtdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotëtëpersonit”.*

Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite Gjykata çmon se për vendosjen e masës parandaluese të konfiskimit, është e domosdoshme vërtetimi i ekzistencës njëkohësisht të tre kushteve që kanë të bëjnë: **1.** Me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në indicje për pjesëmarrje të veprimtari kriminale të parashikuar në nenin 3 të ligjit i cili bën fjalë për fushën e zbatimit të tij; **2.** Me prejardhjen e paligjshme të pasurisë apo mosjustifikimin e zotërimin të saj, referuar nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të tjera të ligjshme të deklaruara dhe **3.** Me zotërimin e plotë apo të pjesshëm të pasurisë nga personi i proceduar drejtpërdrejt apo tërthorazi.

**Në çështjen në gjykim, mbi bazën e provave të paraqitura, të marra dhe të shqyrtuara në kushtet e debatit gjyqësor, gjykata konkludoi për ekzistencën njëkohësisht të tre kushteve të sipërpërmendura për vendosjen e masës së konfiskimit mbi dy apartamentet e banimit, të përshkruara në pjesën hyrëse të vendimit.**



**Së pari:** Ashtu sikurse është arsyetuar në Vendimin Nr. 8 datë 11.06.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me të cilin është vendosur masa e sekuestros mbi pasurinë objekt konfiskimi (vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë), **mbi shtetasin M. K. rëndon dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje për pjesmarrje në veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale.**

Shtetasi M. K. është duke u proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar si e tillë në nenin 287 të Kodit Penal, e cila përfshihet në rrethin e veprave penale të fushës së zbatimit të ligjit (neni 3 pika 1 gërma “d” të tij). Ky procedim ka filluar mbi bazën e informacionit për pjesmarrje të shtetasit shqiptar M. K. në rrëmbimin e një shtetase greke të kryer në Greqi, për lirim të cilës është paguar shuma 1 800 000 Euro.

Çelja e llogarisë bankare në shumën 70 000 në emër të shtetasve M. e N. K. dhe deklarimi për burimin e saj si “E ardhur nga emigracioni”; blerja e dy apartamenteve në vlera të konsiderueshme në periudhën pas aktivitetit kriminal të kryer në Greqi; mungesa e aktiviteteve tregëtare në emër të tij dhe familjarëve; mungesa e deklarimit për para kesh në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë (në datë 25.06.2010 e cila përkon me kohën e përfundimit të aktivitetit kriminal në Greqi); mosha e re dhe realizimi i transaksioneve në periudhën pas Qershorit 2009 vazhdojnë të konsiderohen nga gjykata si indicje të rëndësishme mbi bazën e të cilave qëndron dyshimi i arsyeshëm për pjesmarrje të shtetasit M. K. në veprimtarinë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale, si objekt parandalimi i ligjit në fjalë.

**Së dyti:** Me provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, shtetasi nën hetim M. K. dhe të afërmit e tij, personat e tretë N. e B. K. **nuk arritën të vërtetojnë prejardhjen e ligjshme të pasurisë objekt konfiskimi, me të ardhurat e deklaruara nuk arritën të justifikojnë zotërimin e tyre.**

Në zbatim të pikës 3 të nenit 21 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” nga përfaqësuesi i posaçëm i shtetasit nën hetim dhe personave të tretë u paraqitën me cilësinë e provës deklarimet vjetore të të ardhurave të shtetasve M. K. dhe N. K. në Drejtorinë e Shërbimeve Ekonomike Bashkia Pire, për periudhën dhjetëvjeçare, vitet xxxxx-2009. Në funksion të provueshmërisë së këtyre të ardhurave u paraqitën edhe dokumenta të Insitutit të Sigurimeve Shoqërore IKA në Greqi, për periudhën në fjalë. Gjykata kryesisht, për të vlerësuar se në ç’raport këto të ardhura justifikonin zotërimin e pasurisë objekt konfiskimi, vendosi kryerjen e ekspertimit kontabël. **Akti i ekspertimit kontabël u paraqit me konkluzionin se të ardhurat e deklaruara nga shtetasit M. dhe N. K. nuk arrinin të mbulonin vlerën e pasurisë në shumën 203 382 Euro..**

**Së treti:** Pasuria objekt konfiskimi është nën zotërimin e drejtpërdrejtë të shtetasit nën hetim M. K. dhe të personave të tretë N. e B. K. , të cilët (këta të fundit) janë palë në këtë proces si për shkak të lidhjes së afërt gjinore me shtetasin M.

K., duke qënë në këtë mënyrë subjekte të zbatimit të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ashtu edhe për shkak të zotërimit të pasurisë.

U provua me Shkresën Nr. 1791/1 datë 11.03.2010 të Bankës Popullore se shtetasit M. dhe N. K., kanë çelur një llogari bankare pranë saj në të cilën, në datë 06.07.2009, kanë kredituar shumën prej 70 000 euro, të deklaruar si “E ardhur nga emigracioni”.

U provua, në bazë të Kontratës së Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxx Kol datë 06.07.2009, se shtetasi N. L. K. ka porositur tek shoqëria ndërtuese “xxxxxx” SH.P.K, një apartament me sipërfaqe xx mx, ndodhur në katin e tretë të pallatit në Golem, kundrejt çmimit 70000 euro. Në datë 06.07.2009 shuma prej 70000 euro, nga llogaria bankare në Bankën Popullore, sipas Deklaratës Nr. 4758/602 datë 06.07.2009, është transferuar në drejtim të shtetasit B. P., si pagesë për blerje apartamenti.

U provua se shtetasja B. K., në datë 28.10.2009, ka blerë një apartament banimi tek Shoqëria “xxxx” Sh.P.K, kundrejt çmimit prej 137.800 euro, shumë të cilën e ka likujduar jashtë sistemit bankar. Nga përmbajtja e Kontratës së Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxxx Kol datë 28.10.2009 ka rezultuar se kjo shtetase ka porositur tek Shoqëria “xxxx” Sh.P.K, me ortak dhe administrator shtetasin M. S., një apartament banimi me sipërfaqe xxx mx, ndodhur në pallatin e ndërtuar në Rrugën “Zef Jubani” Tiranë. Pavarësisht se kontrata është përpiluar duke qënë porositëse shtetasja B. K., në kushtet kur ajo nuk ka qënë në marrëdhënie pune dhe nuk ka patur burime të ardhurash, (i pranuar ky fakt edhe në gjykim) porositës faktik ka qënë bashkëshorti i saj, shtetasi M. K..

Në bazë të procesverbbaleve “Për kryerjen e veprimeve përmbarimore gjatë ekzekutimit” datë 13.07.2010 i Zyrës së Përmbarimit Tiranë dhe datë 16.07.2010 i Zyrës së Përmbarimit Kavajë, tabelave të sendeve të inventarizuara si dhe fotografive bashkëngjitur ka rezultuar se shtetasit M. dhe B. K. zotërojnë faktikisht apartamentin e ndodhur në Tiranë ndërsa shtetasi N. K. zotëron faktikisht apartamentin e ndodhur në Golem.

Mbi bazën e argumentimit të mësipërm të ekzistencës së tre kushteve të vendosjes së masës parandaluese të konfiskimit Gjykata, bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, çmon se kërkesa e prokurorisë me objekt konfiskimin e dy apartamenteve të banimit, të ndodhura në Tiranë dhe Golem, duhet të pranohet.

**Në kushtet kur prokurori hoqi dorë nga kërkesa me objekt konfiskimin e automjetit tip xxxx me targa xx xxxx x, në pronësi të shtetasit M. K. dhe llogarisë bankare Nr. 843227/57, çelur në Bankën Popullore, në emër të shtetasit M. K., bazuar në nenin 299 gërma “b” e Kodit të Procedurës Civile, gjykata çmon se çështja duhet të pushohet.**

Në nenin 22 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 parashikohet shprehimisht: “Gjatë gjyqimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të

*Procedurës Civile*”. Në kushtet kur në ligjin e posaçëm nuk ka një dispozitë ku të parashikohet se si veprohet në rastet kur nga ana e prokurorisë hiqet dorë nga kërkesa me objekt konfiskimi, gjykata ju referua nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile në të cilin parashikohen rastet e pushimit të gjykimit, duke qënë njëri prej tyre heqja dorë e paditësit nga gjykimi i padisë. Në këtë disponim gjykata mban parasysh gjithashtu parashikimin në nenin 21 pika 1 të ligjit sipas të cilit, **masa e konfiskimit vendoset me kërkesën e prokurorit.**

**Për sa më sipër gjykata gjeti të pabazuara pretendimet e përfaqësuesit të posaçëm të shtetasit nën hetim dhe personave të tretë.**

1. Lidhur me pretendimin se shtetasi M. K. nuk është subjekt i zbatimit të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, pasi nuk është dënuar për kryerjen e ndonjë krimi, produktet e të cilit më pas janë pastruar prej tij, pavarësisht se ky pretendim është i lidhur më tepër me kërkesën me objekt sekuestrimi, Gjykata e çmon të nevojshme të ndalet duke nënvizuar se, në ligjin në fjalë dhe konkretisht në nenet 3, 11 pika 1 dhe 24 pika 1 gërma “a” të tij ligjvënësi ka parashikuar si kusht **ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicie për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, ku përfshihet edhe vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”**. Gjykata më sipër arsyetoi ekzistencën e këtyre indicjeve ndërkohë që në pikën 2 të nenit 24 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 parashikohet mundësia e vendosjes së masës së konfiskimit edhe në rastet kur procedimi penal pushohet, kur personi deklarohet i pafajshëm apo kur ndryshohet cilësimi juridik i veprës duke qënë vepra e re jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji. Ky parashikim është në përputhje me parimin e autonomisë së procedurës së caktimit dhe zbatimit të masave parandaluese nga procedimi penal, i sanksionuar në nenin 5 paragrafi 1 i ligjit “*Procedura e caktimit dhe zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji*”. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në Vendimin e saj Nr. 4 datë 23.02.2011 në të cilin nënvizon: “*Procedimi i parashikuar në këtë ligj është një procedim i veçantë, autonom nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces...*”

2. Lidhur me pretendimin se prokurori në gjykim nuk solli asnjë provë që të provonte se niveli i të ardhurave të siguruar nga shtetasi nën hetim dhe familjarët e tij nuk justifikonin pasurinë objekt i masave parandaluese, Gjykata konstaton qënien e tij në kundërshtim me nenin 21 pika 3 të ligjit në fjalë ku parashikohet: “*Barra e provës për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi*”. Masat parandaluese të sekuestrimit dhe konfiskimit janë të ndryshme. Ashtu sikurse është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin e saj Nr. 4 datë 23.02.2011, sekuestrimi ka si tipare të tij urgjencën e ndërhyrjes dhe përkohshmërinë e zbatimit të saj ndërsa konfiskimi verifikimin më të thelluar të kërkesës nga ana e gjykatës dhe kalimin përfundimtar të pasurisë në favor të shtetit. Ndërsa gjatë shqyrtimit të masës së sekuestrimit prokurori ka barrën e provës për të provuar se ekziston rreziku që prona të tjetërsohet, humbasë etj, gjatë shqyrtimit të masës së konfiskimit personi, pasuria e të cilit kërkohet të

konfiskohet, ka barrën e provës për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të saj. Një parashikim i këtij detyrimi në ligj është i lidhur ngushtë me qëllimin e vetë ligjit i cili konstiston në parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit përmes ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive. Nëse përfaqësuesi e posaçëm e ka paraqitur këtë pretendim thjesht në kuadër të kundërshtimit të vendimit të sekuestrimit, atëherë ai nuk mund të jetë objekt i analizës së kësaj gjykate duke patur parasysh se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (shih Vendimin Nr. 8 datë 11.06.2010).

**3.** Edhe pretendimi mbi mungesën e provave të paraqitura nga prokurori për të vërtetuar rrezikun e tjetërsimit, i përket gjithashtu kërkesës me objekt sekuestrimi, për të cilën është disponuar me Vendimin Nr 8 datë 11.06.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Në këtë gjykim nuk mund të ngrihet më një pretendim i tillë ndërkohë që, vendimi gjyqësor mbi masën e sekuestrimit është lënë në fuqi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

**4.** Përsa i përket pretendimit për rrëzimin e kërkesës së konfiskimit të pasurisë, për shkak të parashikimit në nenin 5 të ligjit të domosdoshmërisë së urdhërimit nga gjykata të pezullimit të pasojave të zbatimit të masave parandaluese, konstatohet qartë qenia e tij në kundërshtim haptazi me këtë parashikim. Ekzistencën e masave të sekuestrimit apo konfiskimit, të vendosura në bazë të dispozitave të Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi nuk e shikon si shkak për rrëzimin e kërkesës me objekt sekuestrimi apo konfiskimi sipas ligjit në fjalë, por thjesht si shkak pezullimi i pasojave të zbatimit të tyre. Këtë gjë ka bërë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë kur ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për sekuestrimin e pronave. Të njëjtën gjë do të vendoste edhe kjo gjykatë në rast se do të konstatonte se për pasurinë objekt konfiskimi do të ekzistonte më parë një masë konfiskimi, vendosur në bazë të dispozitave të Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale.

**5.** Lidhur me pretendimin se, me provat e paraqitura, provuan se niveli i të ardhurave justifikonte vlerën e pasurisë objekt konfiskimi, gjykata e çmon të nevojshme të sqarojë pse nuk e vlerësoi me cilësinë e provës Aktin e Ekspertimit Kontabël datë 04.02.2011, të mbështetur në të dhënat e nxjerra nga dokumentat e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore Ika Greqi dhe, vlerësoi si të tillë Aktin e Ekspertimit Kontabël datë 25.02.2011 të mbështetur në të dhënat e nxjerra nga formularët e deklarimit të të ardhurave vjetore të Drejtorisë së Shërbimeve Ekonomike, Bashkia Pire.

**Së pari:** Formularët e deklarimit të të ardhurave vjetore u pranuan nga gjykata me cilësinë e provës për shkak të qënies së tyre të vlefshme nga ana formale (akte zyrtare greke të pajisura me vulën apustile të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Athinë, të përkthyer dhe noterizuara) dhe bazuar në nenin 24 pika 1 gërma “b” e ligjit, ku nënkuptohet se justifikimi i zotërimit të pasurive duhet të bëhet me të ardhura, fitime apo veprimtari të ligjshme, **të deklaruara. Pra vetë ligjvënësi e ka vënë theksin tek qenia të deklaruara të të ardhurave, fitimeve etj.**

**Së dyti:** Dokumentat e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore IKA, fotokopjo, të përkthyer dhe

noterizuara, u pranuan nga gjykata me cilësinë e provës në funksion të provueshmërisë së të ardhurave vjetore të deklaruara. Fakti që ndërmjet të dhënave të pasqyruara në to dhe të dhënave të pasqyruara në formularët e deklarimit vjetor të të ardhurave ka një diferencë shumë të madhe, e bën gjykatën të vërë në dyshim vërtetësinë e tyre duke patur parasysh në këtë rast edhe shumat e mëdha të parave të pasqyruara në to si “Dhuratë” dhe që përafrojnë me vetë shpërblimin për punën e kryer.

Për sa më sipër, në kushtet kur dokumentat e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore IKA u pranuan si provë duke u bërë pjesë e dosjes gjyqësore, gjykata e gjeti të pambështetur pretendimin e përfaqësuesit të posaçëm për zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor pasi ajo (pra gjykata) nuk u investua për t’i marrë vetë ato në rrugën e duhur ligjore. Në këtë kuadër ajo e gjen të pabazuar edhe citimin e çështjes B. kundër Shqipërisë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenet 24 pika 1, 25, 26 e 28 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në nenet 299 e 310 të Kodit të Procedurës Civile.

### **VENDOSI**

Pranimin e kërkesës.

Konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive:

**1.** Një apartament banimi, me sipërfaqe xxx mx, ndodhur në katin e shtatë të pallatit në rrugën «xxx xxxxx », Tiranë, përfituar nga shtetësja B. L. K. me Kontratën e Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxxx Rep, Nr. xxxxx Kol, datë 28.10.2009 të lidhur më Shoqërinë «xxxx » Sh.P.K, me administrator shtetasin M. S.

**2.** Një apartament banimi, me sipërfaqe banimi xx mx dhe sipërfaqe të përbashkët x.x mx, ndodhur në katin e xxxxx të një xxxxxxxx në Golem Kavajë, së bashku me garazhin, përfituar nga shtetasi N. L. K. me Kontratën e Sipërmarrjes Nr. xxxx Rep, Nr. xxxx Rep, Nr. xxx Kol, datë 06.07.2009 , të lidhur me shoqërinë «xxxx» Sh.P.K, me administrator shtetasin P. K.

Pushimin e gjykimit të kërkesës me objekt konfiskimin e pasurive:

**1.** Një mjet, tip xxx, me targa xx xxxx x, rregjistruar në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, në datë 05.01.2010, në emër të shtetasit M. N. K.

**2.** Një llogari bankare, çelur pranë Bankës Popullore, me Nr. xxxxxx/xx, në emër të shtetasit M. N. K., në shumën 301 064 (treqind e njëmijë e gjashtëdhjet e katër) lekë.

Meqënëse pala kërkuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda

Tiranë, hoqi dorë.

Për ekzekutimin e vendimit ngarkohen Zyrat e Përmbarimit në Tiranë dhe Kavajë dhe Znj. E. Ç. , administratore në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen shtetasit nën hetim M. K. dhe personave të tretë, N. K. dhe B. K.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit, brenda afatit 15 ditor, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

**U shpall në Tiranë, sot në datë 16.03.2011.**

**SEKRETARE**

**ANDINA KAJA**

**GJYQTARE**

**LILJANA BAKU**